



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 424, datë 8.7.2021

P Ë R

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.645, DATË 3.8.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT
TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE
TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) DHE NDËRTESAVE
PUBLIKE, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM, NË NJËSITË
ADMINISTRATIVE 4 E 8, ZONA "5 MAJI", DHE NJËSINË
ADMINISTRATIVE 6, ZONA "KOMBINAT", BASHKIA TIRANË",
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja "a", të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pika 2.1, e vendimit nr.645, datë 3.8.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2.1. Përdorimi i fondit për vitin 2021 të jetë në masën 990 233 627 (nëntëqind e nëntëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë) lekë dhe i transferohet Bashkisë Tiranë për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike, në zonat e reja për zhvillim në njësitë administrative 4 e 8, zona "5 Maji", dhe njësinë administrative 6, zona "Kombinat", Bashkia Tiranë, në formën e transfertës së pakushtëzuar."

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

**MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ